

VENDIM
Nr.543, datë 9.8.2006

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË INSTITUTIT TË INTEGRIMIT
TË TË PËRNDJEKURVE POLITIKË, TË MJEDISEVE TË VILËS 2-KATËSHE, NË
RRUGËN “ PUNËTORËT E RILINDJES”, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
KËTIJ INSTITUCIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi të plotë administrimi dhe transferimin e mjediseve të Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë, nga kati i parë i ndërtesës së ish-Komitetit Qendror, në mjediset e vilës 2-katëshe, me adresë rr.“Punëtorët e Rilindjes”, aktualisht në shfrytëzim të Shoqatës Kombëtare të të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, sipas planimetrisë, “Aneksi 1”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë të marrë masa për të krijuar, në këtë ndërtesë, mjedise mbledhjesh, të cilat t’ua vërë në dispozicion, pa kundërshtim, shoqatave kombëtare, të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë të regjimit komunist, për veprimtari dhe konferenca.

3. Kalimin, në dispozicion të Këshillit të Ministrave, për fond zyrash, të mjediseve, në administrim të Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë, në katin e parë të ndërtesës së ish-Komitetit Qendror, sipas planimetrisë, “Aneksi 2”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet aparati i Kryeministrit, drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1


Legazione d'Italia

PIANO RALATO



Scala 1:100

PRIMO PIANO




Aneksi 2

07196

PLANI ENDOGES
Rr. Përdorues & Rrindjes

TR 375/04/2081x



DIPAS PLANIT ARRILUJ
NDËRHET NE ZONEN E
QELBERIMIT TE BANIMIT.
PER URB. STUD.
M. KURFI
G. PAPAVASILI
14.12.93

ZONA
KONFERENCA
GJALISTE TE RADISTRES URBANE
TASHA LILAJ DHE ARZIRO BAKSHI
SHEFTE E TAEASHES URBANE
NATASHA LILAJ
KONSTRUKTOR
KOZETA GJEDISHI

Rilievi i Tiranës
Shk 1:500 vit 1993
Ritervor Ing. G. Gjeteshi
Hartoi

10. Gjeteshi G. Gjeteshi
10. Gjeteshi G. Gjeteshi



10. Gjeteshi G. Gjeteshi
10. Gjeteshi G. Gjeteshi

